



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

Nr.13/541
Më: 18.09.2017
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.17/2009 të datë 28.08.2009, Udhëzimit Administrativ nr.06/2015- normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT NR.231 të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS- plotësues

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2017/2018.

1. SHFMU " Sezai Surroi"- Bellobrad
 - Një mësimdhënës për mësim klasor në paralelen e ndarë fizike Zym, deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.
2. SHFMU " Fetah Sylejmani"- Dragash
 - Një mësimdhënës për mësim klasor në paralelen e ndarë, Rrenc.
3. SHFMU " Shaban Shabani"- Llopushnik
 - Një mësimdhënës për lëndën e Kimisë (18 orë mësim)
4. SHML "Ruzhdi Berisha" Dragash
 - Një profesor për lëndët e Farmacisë 10 orë në javë
5. Një mësimdhënës për gjuhë gjermane, për të gjitha shkollat e komunës së Dragashit

KUSHTET:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas Udhëzimeve Administrative të MASHT –it (Normativi mbi kuadrin profesional të Arsimit të përgjithshëm).

Formularët për konkurs merren në Drejtorin e Arsimit në Dragash, ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.

Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide, certifikata e lindjes, certifikata që nuk është në hetime, kopja e letërnjoftimit.

Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës , duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar.

Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të futen në listën e ngushtë.

Konkursi mbetet i hapur **8 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Më:18.09.2017.
Dragash



Drejtori i DKA-së
Tafil Krasniqi